

DOKUDAILY

NUMRI I TRETË

EDICIONI XXIV

E DIEL, 3 GUSHT 2025

THIS NIGHT HAS OPENED MY EYES
AND I WILL NEVER SLEEP AGAIN

Rekomandime

Faqe 03

Mbi filmat

Faqe 04

DokuTalks

Faqe 06

FOTO: FERDI LIMANI

NJË SHKOP SHPRESE PËR TA KAPËRCYER MURIN

Një tank në një rrugë të shprazët. Një palestinez del nga shtëpia, me një thes të bërlllogut në dorë, duke biseduar në telefon i afrohet një kante të bërlllogut. Gryka e tankut e ndjek burrin duke ecur majtas e djathtas, me tingujt e një hidrofori në prapavijë. Në çdo moment pres që tenka do ta qëllojë palestinezin që është duke folur në telefon.

Kjo skenë është nga filmi “The Time That Remains” apo “Koha që Mbetet” nga regjisori palestinez Elia Suleiman, i cili ka arritur të krijojë një film poetik që ta then zemrën e të mbushë me shpresë. E pyetja ime në këto kohë është: a ka shpresë? - kur gjenocidi nga Izraeli ndaj palestinezëve në Gaza është duke u transmetuar live dhe të gjitha mekanizmat për ndalimin e gjenocidit, të ndërtuar nga përvoja e Holokaustit, kanë dështuar?

E drejta ndërkombëtare, të drejtat e njeriut, nuk vlejnë për Izraelin. Kur themi që është gabim të bombardohen fëmijët, përgjigjja është që jemi antisemitë dhe mbështesim terroristë.

Çka kanë faj fëmijët? Izraeli ka vrarë mbi 18 mijë fëmijë palestinezë brenda afro dy vitesh. Kjo i bie rreth 25 fëmijë në ditë, një fëmijë çdo orë. Por të fuqishmit e kësaj bote na sigurojnë që ky realitet i ri është normal. Si mund të jetë normale me vra një fëmijë çdo orë?

Në fund të filmit të Suleimanit, një sportist me shkop të gjatë e kapërcen murin izraelit në shenjë revolte ndaj ndalesave të lëvizjes së lirë të palestinezëve. Aq absurd më duket ky normalitet i ri, sa që shpresoj të jem brenda filmit të Suleimanit – dhe që në fund të filmit më pret shpresa.

Shkruar nga Ilir Hasanaj



REKOMANDIME

RIVER OF GRASS / 83'
INTERNATIONAL FEATURE DOX



DOKUKINO 17:30

HENRY FONDA FOR PRESIDENT/ 184' -
SPECIAL SCREENINGS



SHTËPIA E KULTURËS (SALLA E MADHE) 18:30

MAY THE SOIL BE EVERYWHERE/ 96'
GREEN DOX




DOKUKINO 19:30

THE TRACK/ 91'
BALKAN DOX



KINO LUMI 20:00

THE MOUNTAIN WON'T MOVE / 91'
BALKAN DOX



KINO LUMI 22:30

SPECIAL OPERATION / 64'
INTERNATIONAL FEATURE DOX



DOKUKINO PLATO 22:30

MBI FILMAT

E gjithë jeta e bërë bashkë: Mes miqësisë, festivale dhe ideve

Në bisedë me me Pamela Cohn dhe Brett Story



DokuFest sjell miq të vjetër e të rinj në Prizren gjatë javës së festivalit e një nga pranitë më familjare të këtij festivali është të shohësh Pamela Cohn pranë DokuKinos. E Brett, regjisore, profesore e gjeografe, nuk e ka për herë të parë ardhjen në Prizren. Këtë vit në DokuFest Cohn, vjen edhe si kuratore e programit të veçantë Spotlight: Brett Story.

Ditën e djeshme DokuDaily takoi regjisorin Brett Story dhe kuratoren Pamela Cohn, për një bisedë lidhur me filmat e Story, mbi poetikën, familjaren dhe shtrirjen e butë të anktheve kolektive në narrativat e përditshme.

E Brett, regjisore, profesore e gjeografe, nuk e ka për herë të parë ardhjen në Prizren.

Bashkëpunimi i tyre nisi si nevojë për të patur vizibilitet, problematikë që Brett Story e pat vënë re vite me parë. Ato u takuan për herë të parë në një festival filmi dokumentar në Montreal e menjëherë e celi këtë portë të ndërlihdjes duke synuar që puna e Story të kuptohet në përplotësi dhe në audienca të reja. Cohn thotë: “Është e vështirë të fitosh një farë vëmendjeje. Ndonjëherë flisim për këtë, dhe kemi folur shumë. Dhe sa rreth i mbyllur është ndonjëherë, ndaj të jesh në gjendje të sjellësh dikë dhe të ndash vizionin e tyre më të gjerë është thjesht, mendoj se është një privilegj i vërtetë, të paktën për mua si kuratore/programuese..”

Punimet filmike të Brett Story, vijnë në formatin e fokusit dhe jo të retrospektivës, kjo për ta parë në një tjetër dritë dhe Cohn rrëfeu se ky format e ndihmon këtë proces të të parit e punës së një regjisorit pasi i shërben të komunikuarit të një hendeku të madh se regjisorët e rinj e kanë të vështirë të gjejnë vendin e tyre në industri dhe rritja jo eksponenciale e suksesit ndonjëherë e gjen një regjisor në një vend kanonik pa ritëm të renduar në kohë. Por gjithashtu gjenden hapësira të ndryshme që e gjithë kjo punë e kryer ndër vite, ta gjejë audiencën para një kumti të formësuar mirë.

Ne i pyetëm Cohn dhe Story lidhur me filmat e paraqitura në këtë program që paraqet gjashtë filma me metrazh të shkurtër dhe dy me metrazh të gjatë që përkasin tematika nga artikulimi sa sflitës, përsëritës po aq edhe i qetë në rutinën që njeriu në mënyrë për t’ia venë vendin vetes në botë, po aq sa te të drejtat e njeriut dhe të luftuarit kundër padrejtësive sistematike e ligjore, apo te reflektimet që harkojnë probleme kolektive nën lensin e personale. Cohn na ofroi një lexim të sajën mbi mënyrën se si mund ta shohim këtë program duke shpjeguar se shpeshherë ajo i takon artistët me të cilët punon pasi ajo ka parë punët e tyre dhe puna e saj si programuese shpesh orientohet nga ky pikëtakim i parë me se cfarë regjisorët kanë prodhuar.

“Mendoj se kjo është ajo që përbën idenë e një artisti dhe të një kuratori: këto momente që ndihen si kolektive, edhe pse vendet ku filmi mund të shkojë janë të ndryshme e të largëta nga njëra-tjetra, ekziston një pikë referimi që ndjehet shumë njerëzore, shumë e rrënjësuar në përvojën njerëzore.”

Puna e tyre e përbashkët, lidhet shumë me eksperiencat jetësore duke e gjetur veten në një zallamahi të përvijshueshme e duke shpresuar se këto filma dhe receptimi i tyre i jep një sens përbashkësie dhe ngushëllimi audiencave në mënyrën se si bota rendon problemet në jetët e njerëzve e mbi të gjitha se ata nuk janë vetëm.

“Nuk jam e vetmja që po përjeton këtë dhimbje mendore. Ndaj mendoj se është një mënyrë shumë intime për të pasur një përvojë kolektive. Dhe secili, çdo person, çfarëdo që sjell me vete, çfarëdo që filmi ngjall tek ai, është pikërisht ajo shpresë që kjo të ndodhë, që të dalësh nga kinemaja jo domosdoshmërisht i ngushëlluar, s’është fjala që dua të përdor, por i lidhur, dhe jo aq i izoluar. - thotë Cohn.

Lidhur me filmat e saj, fokusohemi në filmin “A Debtor’s Prison” dhe mbi idetë fukoiane se si sistemi që prodhon si disiplinë dhe estetizon ndëshkimit kthehet në një qerthull lufte të një individi, por gjithashtu mbi se si krijohet ndjesia e familjaritetit. E Brett ndalet në këtë fjalë:

“Më pëlqen kjo fjalë “familjare”, sepse për mua, në njëfarë mënyre, është njëkohësisht pika e nisjes dhe një objekt i domosdoshëm për t’u kundërshtuar në filmat e mi, në kuptimin që jam shumë e interesuar politikisht për mënyrën se si mund të arrijmë një lloj vetëdijeje që na lejon të shohim sistemet tona të besimit, veçanërisht mënyrat dhe modelet e të menduarit që na duken po aq natyrale sa ajri që marrim frymë.”

Bashkëpunimet dinë të jenë shpesh marrëdhënie të cilat edhe mund të ndërlikohen, por si Pamela edhe Brett e njohin kënaqësinë e të punuarit me njerëz që dinë të përpunojnë fjalën dhe mendimin dhe se e gjithë kjo prapaskenë e një miqësie mes filmave, që nuk gjendet shpesh në rrethinat e festivaleve të filmave, kur rrënjësohet në të diskutuarit e thellë mbi idetë, prej saj mund të lindë jetëgjatësia e të punuarit bashkë. Por mbi punrën e saj si kuratore Cohn shprehet kështu: “Kuratori është aty pikërisht për ta bërë atë një vepër arti në çast, për ta marrë dhe për ta lënë të jetojë në një botë marrëdhëniesh, në vend që të mbetet në një hapësirë të vetme, të ngushtë dhe jo plotësisht të gjallë të imagjinatës personale.”

Ky bashkëpunim i qëndrueshëm na fton të gjithëve të reflektojmë më shumë mbi mënyrën se si mund ta perceptojmë botën sot dhe në një farë mënyre të kapim botën duke rrëzuar fasadat e saj. Ky proces bazohet në diskutimin, leximin dhe mendimin e thellë mbi botën në të cilën jetojmë dhe mbi mënyrën se si lidhemi me njëri-tjetrin. Për të gjithë ju që keni fatin të jeni në Prizren, ju ftojme të mos e humbisni sesionin masterklasës me Brett Story në bisedë me Pamela Cohn, që do të mbahet më 5 gusht në Shkollën e Muzikës “Lorenc Antoni” në orën 16:00.

MBI DOKUTALKS

T'i hapim dritaret, ta thyejmë heshtjen: Gratë e Paqes dhe të Drejtësisë



FOTO: FERDI LIMANI

Paneli i parë i DokuTalks, me temën “REZISTENCA – Gratë e Paqes dhe të Drejtësisë në ish-Jugosllavi dhe Shqipëri”, trajtoi ndikimin që patën luftërat në Ballkan mbi gratë dhe mënyrat se si ato po përballen sot me këto pasoja.

Panelistë ishin filmbërëset Kumjana Novakova e Norika Sefa, kritiku i filmit, Sanjin Pejkovic dhe studiuesja Blerina Hankollari, ndërsa moderatore ishte Aurela Kadriu, sociologe dhe menaxhere kulturore.

Regjisorja Norika Sefa theksoi se është e rëndësishme të vazhdohet kërkimi dhe hulumtimi i së vërtetës mbi dhunën ndaj grave gjatë luftërave, për shumë arsye: tregimi i historive të viktimave rikthen dinjitetin, mundëson ndërtimin e urave lidhëse mes të mbijetuarave dhe “shtrojnë pyetje” në shoqëri rreth krimeve të luftës, në mënyrë që ato të mos harrohen dhe të mos përsëriten. Blerina Hankollari diskutoi për sfidat e grave në Shqipëri, të cilat janë viktimizuar nga shtypja patriarkale, si dhe nga komunizmi, i cili solli varfërinë ekstreme dhe mungesën e të drejtave civile që erdhën si imponim për të gjithë në Shqipërinë e së kaluarës së afërt. “Në Shqipëri kemi një problem të madh përballë të kaluarës sonë në mënyrë të singertë. Ekziston një rezistencë ndaj së vërtetës, pasi ajo është njëkohësisht e dhimbshme dhe e turpshme.”

U diskutua shkurtimisht edhe për librin e fundit, bashkautor i të cilit është Kumjana Novakova, me titull “Rezistenca: gratë e paqes dhe të drejtësisë në ish-Jugosllavi dhe Shqipëri”, ndërsa të pranishmëve iu dhurua një kopje falas e librit. Në përmbledhjen e librit thuhet: *“Nëpërmjet dëshmime personale të 11 grave, ky libër zbulon rolet e tyre vendimtare në sfidimin e sistemeve patriarkale dhe ideologjive nacionaliste, për të mbrojtur paqen, drejtësinë dhe të drejtat e njeriut. Ai pasqyron luftën e tyre të pandalshme për të vërtetën, pajtimin dhe njohjen e krimeve të luftës; nga dokumentimi i mizorive, tek organizimi i protestave dhe udhëheqja e iniciativave humanitare.”*

Sanjin Pejkovic diskutoi mbi konceptin e “përplasjes së kujtesave” dhe se si përvetësimi i rrëfimeve të të mbijetuarave po përdoret sot nga aktorë nacionalistë për të fituar pushtet politik, me shpresën për të zgjeruar ndikimin e tyre. Kjo do të thotë se gratë që kanë kaluar këto tmerre po shfrytëzohen tani për përfitime politike.

Ai theksoi rëndësinë e punës së studiuesve të mëparshëm dhe se ata që janë të angazhuar tani në këtë përpjekje po e ndërtojnë punën e tyre mbi themelet e atyre hulumtimeve, dhe duhet ta vazhdojnë atë, pavarësisht sa e pakëndshme mund të jetë për ata që duan të harrojnë të kaluarën.

Filmbërësja Kumjana Novakova ritheksoi se kjo punë duhet të vazhdojë. Ajo tregoi se shpesh i është bërë pyetja: “A nuk është trajtuar mjaftueshëm lufta tashmë, a nuk e kemi treguar tashmë këtë histori?” dhe përgjigjja e saj ishte e prerë: “Jo! Historia nuk është treguar plotësisht dhe ne duhet ta kemi parasysh të gjithë panoramën.”

Aurela, gjithashtu e komplimentoi Kumjanën duke thënë: “Është e rrallë të shohësh një film ku egoja e regjisorit nuk del në pah, por ti ia dole.”

Aurela u shpreh edhe për shumë nga vështirësitë që shoqërojnë përpjekjet për të dokumentuar saktë mizoritë e së kaluarës: gjetjen e të mbijetuarave, fitimin e besimit të tyre për t’u shprehur, dhe pranimin e realitetit se natyrshëm do të ketë boshllëqe në informacion. Ajo theksoi gjithashtu rëndësinë e shmangies së “kolektivizimit” të rrëfimeve, duke u dhënë secilit të mbijetuar hapësirën dhe dritaren e vet: “Jo vetëm një, por shumë dritare të vogla.”

Një dritare, ç’mënyrë e përshtatshme metafore. Ajo lë të hyjë dritën, dritën që shëron. Ajo lejon të tjerët të na shohin, nëse ne zgjedhim, dhe na lejon edhe ne të shohim ata. Këto dritare të vogla në shpirtin e viktimave të së kaluarës nga trauma, dhuna dhe shtypja janë jashtëzakonisht të rëndësishme, sepse na japin mundësinë t’i shohim dhe t’i dëgjojmë. Ky është një hap i fuqishëm drejt shërimit, kapërcimit dhe për t’i vënë përgjegjës fajtorët. Vetëm përmes këtyre historive, drejtësia mund të vihet në jetë.

Kjo bisedë u organizua në bashkëpunim me Pro Peace dhe YIHR Kosovo.

MBI
DOKU.TECH

Në udhëkryqin mes artit dhe algoritmit



Në një botë ku inteligjenca artificiale po bëhet pjesë e përditshmërisë sonë, nga puna e përditshme deri te arti që konsumojmë, pyetja nuk është më nëse do ta përdorim atë, por se si do ta trajtojmë. Me këtë qasje ka filluar edhe diskutimi i Ralph Talmont, ekspert i komunikimit kulturor dhe sipërmarrës në art në edicionin e 12-të të DOKU.TECH në kuadër të DokuFest-it, "Bringing The Future Closer Together", që synon eksplorimin e bashkëdyzimit të artit dhe teknologjisë, duke u fokusuar në origjinalitet në kohën kur veçse jemi "pushtuar" nga Inteligjenca Artificiale. "Kjo nuk do të jetë një bisedë për teknologjinë, por për një qasje që duhet ta kultivojmë ndaj saj", ka thënë ai.

Në të njëjtën kohë ai pyet nëse duhet ta urrejmë teknologjinë? Dhe menjëherë përgjigjet me një jo të madhe para audiencës së mbledhur në Shtëpinë e Kulturës në Prizren. "Është hipokrizi të urrejmë diçka që e përdorim çdo ditë, por është vitale që të kultivojmë një qasje ndryshe ndaj saj, sepse pasojat që vijnë pas kësaj do të determinojnë kursin tonë jetësor", shpjegon Talmont.

Duart e gati secilit që ishte prezent në audiencë u ngritën lart kur ai shtron pyetjen se sa prej tyre e përdorin teknologjinë gjeneruese për të kryer punë në jetën e tyre profesionale, gjersa edhe vetë autori i këtij shkrimi përdorte një makinë gjeneruese për të transkriptuar atë se çfarë Talmont ka thënë. Kjo dëshmon fuqishëm rëndësinë e organizimit të një diskutimi të tillë, që shërben të bisedojmë për atë që nuk mundemi thjesht ta evitojmë.

Megjithatë, Inteligjenca Artificiale nuk mund të bëj gjithçka, si për shembull nuk mund të ndërhyjë ashtu në çast me një performancë të këndshme muzikore me saksofon ashtu siç bëri Arian Randobrava, muzikant nga Prizreni gjersa Talmont fliste për rëndësinë dhe ndikimin e punonjësve kulturorë në zhvillimin shoqëror. "Inteligjenca artificiale nuk mund të riprodhojë luftën krijuese që formëson artin autentik. Provat dhe përsëritjet... janë aty ku ndodh magjia. Përpjekja që investoni në prodhimin e artit është pika ku krijohet magjia. Arti krijohet përmes provave dhe gabimeve, duke u përpjekur, duke dështuar dhe duke u përpjekur përsëri," vazhdon Talmont.

Tutje, ai parashikon një të ardhme ku origjinaliteti bëhet një produkt me vlerë dhe mënyrat e qarta për të dalluar artin e krijuar nga njeriu nga krijimet e inteligjencës artificiale do të jenë thelbësore. "Në një botë të mbushur me art të krijuar nga inteligjenca artificiale, ajo që është njerëzore, autentike dhe e vërtetë ka potencialin të marrë më shumë vlerë. Hulumtimet shkencore tregojnë se njerëzit zakonisht preferojnë artin që besojnë se është krijuar nga njerëzit, dhe shumë presin ditën kur algoritmet do të përfshijnë etiketa të verifikuara që dallojnë qartë përmbajtjen origjinale dhe njerëzore", parashikon Talmont.

Pas edhe një pike muzikore nga Randobrava, fillon një bashkëbisedim mes Ralf Talmont dhe Veton Nurkollari, drejtor artistik në DokuFest.

Nurkollari shpreh zhgënjimin e tij duke thënë se njerëzit nganjëherë mund të jenë "injorantë", të mashtrohen lehtësisht nga arti artificial.

Në anën tjetër, Talmont e thekson "dembelizmin" njerëzor si një problem thelbësor, duke shpjeguar se teknologjia dhe inteligjenca artificiale na inkurajojnë të kërkojmë rrugën më të lehtë, duke zvogëluar përpjekjen dhe angazhimin e vërtetë.

Nurkollari ka vënë pah edhe mungesën e informatave në masa për cilësinë e produkteve kulturore. "Njerëzit në përgjithësi janë të painformuar ku shumica nuk kanë trajnim për të njohur cilësinë, si në fotografi apo në produkte tjera kulturore, dhe si rezultat, përmbajtja e gjeneruar nga inteligjenca artificiale do të bëhet aq bindëse sa shumica thjesht nuk do t'ia dinë". Por Talmont thekson se ka gjëra që makinat ende nuk mund ta kopjojnë. "Ne jemi përtacë nga natyra njerëzore. Ky dembelizëm ose më saktë, kjo dashuri për të bërë gjërat pa shumë përpjekje është një tipar njerëzor. Nuk është domosdoshmërisht një gjë e keqe; në fakt, mund të jetë edhe e dobishme. Por kur bëhet fjalë për kulturën, ka ende shumë gjëra që njerëzit mund të na japin të gjithëve, diçka që makinat ende nuk mund ta kopjojnë". Në këtë epokë të dominuar nga Inteligjenca Artificiale, ne ndodhemi në një udhëkryq që ta kujton "Paktin e Faustit" të Neil Postman. Po shkëmbejmë kreativitetin autentik njerëzor për lehtësinë joshëse të automatizimit.

Ashtu siç deklaruan Nurkollari dhe Talmont, derisa njerëzit mund të jenë dembelë ose edhe "injorantë" përballë përmbajtjes dërrmuese artificiale, megjithatë ekziston ende një shkëndijë e pazëvendësueshme në artin njerëzor e lindur nga lufta, papërsosmëria dhe përsëritja.

Makineritë mund ta përmbytin botën me imitim të pafund, megjithatë ato nuk mund ta kapin thelbin e çrregullt dhe shpirtëror që vetëm njerëzit i sjellin kulturës. Sfida përpara është e qartë: t'i rezistojmë mbytjes në oqeanin e gjerë të zhurmës artificiale dhe në vend të kësaj të kultivojmë hapësira ku lulëzon kreativiteti i vërtetë.

Shkruar nga Shefket Bujari

RECENSIONE

Blue Heart – Coeur Bleu (2025)



Pas lirit të kuq, zhytur në predikime të heshtura, fshihet një zemër blu. Duke pritur, duke pritur një ëndërr amerikane. Blue Heart (2025) është një film fikSION nga Samuel Suffren, i cili përqendrohet te prindërit haitianë Marianne dhe Pétion, ndërsa presin një telefonatë nga djali i tyre, i cili ka emigruar në Amerikë. Ndërsa shëndeti i Marianne përkeqësohet nën peshën e stresit, Pétion lihet të mbështesë iluzionin e suksesit dhe stabilitetit, një gënjeshtër nga e cila ai e mbron me kujdes.

Filmi i Suffren është një portretizim i sinqertë dhe i gjallë njerëzor i idealizimit ngjites të Amerikës që ka zënë rrënjë në komunitete anembanë globit. Ai jo vetëm që kap stresin e madh që familjet durojnë në përpjekjet e tyre për të emigruar në SHBA, por gjithashtu qëndron në erozionin e qetë të atyre që kanë mbetur pas. Duke përdorur një raport të ngushtë aspektesh dhe një kamera statike, filmi intensifikon ndjenjën e izolimit që rrethon prindërit.

Përpjekjet e Pétion për normalitet, duke përfshirë unazat e ditëlindjes, kërcimin me kërcim dhe kartëmonedhat e blera, ndihen edhe më të kota në këtë sfond shtrëngimi. Ky është një film që e përndrit sensin kritik ndaj tematikës së trajtuar. Dhitë shfaqen shpesh gjatë gjithë filmit, duke simbolizuar ritmet familjare të jetës së Marianne dhe Pétion. Kur dikush çohet në thertore, Suffren sfidon në mënyrë delikate qëndrueshmërinë e kësaj ekzistence. Duke ngritur pyetjen: a mund të zgjasë vërtet një jetë e mbështetur vetëm nga pasiviteti dhe sakrifica? Kjo pyetje, së bashku me kritikën e saj të lindur për koston psikologjike të imperializmit amerikan, formon dogmën e këtij filmi, duke e bërë Blue Heart një film të domosdoshëm dhe thellësisht bindës.

Shkruar nga Carson Beale


After Colossus (2024)



Kjo është një histori për një djalë indonezian i cili mori pjesë në eksperimente të fshehta psikologjike në rininë e tij dhe dëmin që i shkaktuan ato. Fatkeqësisht, testohet përsëri si i rritur dhe pësoi lëndime të mëtejshme. Ky film kishte një skenë që të kujtonte filmin "Ekzorcisti", kështu që dëmi i shkaktuar këtij shpirti të varfër ishte i thellë. Duket se shkencëtarët e përfshirë kaluan disa vija të ashpra, pasi ata mund të kenë krijuar një përbindësh, një "tigër": gjysmë njeri, gjysmë tigër, por të gjithë të këqij, pasi tani po vret fshatarë. Në fund, në titrat, kjo rresht: "Ndonjëherë, vija ndarëse midis reales dhe asaj që ndërtojmë është e vështirë të dallohet". A është kjo një histori e bazuar në ngjarje reale? A është thjesht trillim? Ishte e vështirë të dallohej, por megjithatë një përpjekje që të nxit mendimin. Rinia di të përshtatet lehtë, por ka një shpirt tërhequr shumë larg, shumë fort, e gati mund të thyhet.

Shkruar nga Scott Hoy

Kneecap (2024)



Politikat e të festuarit: “Kneecap” i bashkohet aventurës dhe emocionit, kjo nuk është diçka që mund ta shikosh vetëm: një udhëtim me tren (lidhje interesante duke pasur parasysh ndikimin e tij shumë të dukshëm vizual të "Trainspotting") ku thjesht mund të kërcesh dhe të kalosh nëpër të gjitha lëvizjet me këta personazhe të hatashëm. Mund të qeshësh, të qash ose edhe të përpiqesh të këndosh së bashku me ta në gjuhën gaelike. Nëse i njuh nga muzika e tyre e jetës reale, do ta adhurosh aspektet e trillit. Nëse ke dëgjuar për filmin, do ta adhurosh realitetin pas atij që tani është filmi më me ndikim në gjuhën irlandeze të dekadës.

Dhe gjithçka filloi vite më parë në Dublin, ku regjisori i ardhshëm britanik Rich Peppiatt shkoi të shihte këtë grup hip-hop në një bar dhe u mahniti nga performanca e tyre me gjuhë të përzier, anti-establishment / me protestën e fortë të këngës "Brits Out". Trioja nga Belfasti, Irlanda e Veriut, e përbërë nga Mo Chara, Móglaí Bap dhe DJ Próvaí, me shumë mundësi nuk e kishin idenë se ky takim do t'u jepte një çmim BAFTA, një çmim Sundance, një çmim BIFA dhe madje edhe një çmim Oscar. Dhe që nga ky debutim, ata kanë nxitur një numër të madh protestash pro-irlandeze dhe anti-lojaliste, gjë që është gjithashtu në përputhje me qëndrimin e hershëm pro-palestinez të grupit.

Ajo që duhet të kishte qenë një akt shumë normal i të kënduarit në gjuhën e nënës, bëhet një akt revolucionar kur bëhet fjalë për të shtypurit, dhe kushdo që ka edhe njohuritë më të vogla për kolonializmin dhe luftën, e di se asimilimi fillon me gjuhën. Kjo është në ballë të thelbit të Kneecap si një grup faktik dhe i trilluar, me shprehjen "Çdo fjalë e folur irlandeze është një plumb për lirinë irlandeze" që u mësohet djemve nga personazhi i luajtur nga irlandezo-gjermani Michael Fassbender. Filmi biografik vetë-mitologjik rreth kësaj tresheje të jetës reale, i vendosur në sfondin kompleks politik të Belfastit të viteve 2010, është plot me substanca narkotike, tuta sportive dhe trauma gjeneratash. Kneecap nuk i shmangen përdorimit të drogës, as hedhjes së qeseve të ketaminës në shfaqjet e tyre, as pikëpamjeve të tyre politike dhe performancave të egra në skenë. Dhe është përmes këtyre akteve të papërpunuara/të hapura që ata i zbatojnë pasojat e luftës dhe kolonializmit, duke përforcuar fuqinë absolute që arti (dhe festa!) ka mbi politikën dhe shoqërinë

Shkruar nga Romina Ruda.

General Sponsor



ProCredit Bank

DOKUNIGHTS

Imagjinoni pak: Silueta e një DJ në sfondin e peizazhit të shkëlqyer të qytetit të Prizrenit. Shkëlqime të ngrohta të kuqes dhe të bruztës ndriçojnë fytyrat e bukura të një turme euforike. Një çift, i mbështetur në strukturat e vjetra prej guri të Kalasë, me kokat që tundnin ritmin, sytë e fiksuar tek njëri-tjetri. Është kaq mirë që jemi sërish këtu: gjatë një nate që zgjati deri në lindjen e diellit, DokuNights u rikthye, duke e magjepsur përsëri qytetin.

Më së pari në Sonar Stage, pamë një vepër të projektuar në mënyrë mbresëlënëse e mbushur me drita sipër kokës, altoparlantë të fuqishëm dhe pjesën qendrore, një oval bronzi triumfues që ngrihej në sfond dhe në skenë hyn: Rebiswan. Ata ishin menjëherë në elementin e tyre: cigare në njërën dorë, kontroll i plotë mbi platformën në dorën tjetër, kombinimi i tyre i shkëlqyer i basit të fuqishëm, perkusionit shtytës dhe house-it flow-state nuk e ngrohu aq shumë turmën sesa i ndezi, duke vërtetuar pse janë një nga talentet më emocionuese që kanë dalë nga skena underground e Kosovës.

Duke ruajtur atmosferën e përkryen, Byron Yeates nga Berlini, na njohu me muzikë disko nga një krejt tjetër planet përpara se ta çonte në një nivel tjetër: me një set elegant dhe i shndritshëm plot gëzim dhe surprizë - në një moment madje duke u futur në basin e mprehtë të teknos industriale

‘WORK’ ishte sample-i vokal të këngës hapëse të IN2STELLAR nga Melbourne, por seti i tyre ishte i ndërtuar si një lojë, duke e rritur ritmin derisa në tingullin e fundit.

Sa mirë që jemi këtu sërish!

Duke thurur në mënyrë të rehatshme probleme ritme house dhe grepa melodikë, duke nxitur përfundimisht trupën e tyre të kërcimtarëve të improvizuar në skenë, energjia e tyre e papërm-bajtshme e la turmën me shumë lumturi drejt zanafillës së lindjes së diellit.

Momentet e mbrëmjes së kaluar (dhe të mëngjesit të sotëm) nuk do të ndalen: festa vazhdon me sensacionin shqiptar Shkodra Elektronique (Kolë Laca dhe Beatrice Gjergji), të cilët ngjiten në Sonar Stage sonte për llojin e tyre magjepsës të folktronikës së mprehtë dhe pulsuese. Pasi na rrëmbyen zemrat në Eurovision të këtij viti me këngën e preferuar të fansave 'Zjerm', ata janë këtu për të bërë kaos në kala.

Duke pyetur prizrenasit mbi emocionet e tyre për këtë performancë, shumë prej tyre vunë re se mezi presin ta dëgjojnë Zjerm drejtpërdrejt. "Nuk e kam dëgjuar kurrë muzikën e saj drejtpërdrejt. Ata ishin në Eurovision - do të doja shumë ta dëgjoja këtu", thotë Anjeza. Në mënyrë të ngjashme, Shefket më thotë se "Na dhanë kaq shumë emocione në Eurovision. Ua tregoja të gjithë miqve të mi ndërkombëtarë. Për fat të keq, ata nuk fituan, por ne na i fituan zemrat". Megjithatë, jo të gjithë janë këtu vetëm për muzikën. Era ndjek një qasje të ndryshme: "Dua vetëm të shoh se çfarë veshjeje të re do të veshë Beatrice Gjergji."

Epo, pavarësisht prioriteteve të tyre, del e njëjta ide: të gjithë në Prizren mezi presin shfaqjen e Shkodra Elektronike sonte. Shihemi atje, për një moment tjetër ikonik në historinë e DokuNights.

Shkruar nga Gus Edgar-Chan




FOTO:GRESA NUREDINI

General Sponsor



Principal Partner



Principal Partner



Golden Sponsor

